

## Falsitetet Logjike

Falsitetet logjik quhet një argument që ‘maskohet’ si i shëndoshë, por që mund të hidhet poshtë sepse ai shkelë parimet e logjikës. Ai mund të dallohet prej paragjyimit kognitiv, pikpamjes subjektive, dhe mashtrimit.

1. Tri kategoritë falsitetesh janë të randsishëme:

- falsitetet formale, ose gjuhsore
- falsitetet në arsyetim
- falsitetet emocionale

Problemi më i madh i falsiteteve është se disa mund t’i përdorin ato me manipulua audiencën, çka mund të arrihet duke përdorë gjuhë të paqartë dhe të pavërtetë (Aristoteli).

Tipikisht, falsitetet logjike lidhen kryesisht me retorikën a mënyrat tjera bindëse që përdoren prej atyne që përpiqen me ndikua mbë audiencën e tyre: shitësve, influencersve në rrjetin shoqnor, blogistëve, gazetarëve, folësve në programet televizive, politikanëve, ligjruerëve para jurisë, dhe veçsisht officerët para ushtarëve që po përgatiten të sulmojnë ushtrinë kundërshtarë. Këto fusha mendimi mund të quhen fushat e falsiteteve të vetdijëshme e të qëllimëshme, sepse këtu falsitetet përdoren me cak me ndikua mbë opinionin e audiencës.

Akademistët e shkrimtarët profesionistë përpiqen t’iu shmagen falsiteteve logjike sepse në shkrimet e tyre cakohet me gjetë të vërtetën; jo me kënaqë emocionet e një audience. Megjithatë, edhe shkrimtarit akademik i duhet t’i qëndrojë besnik një platforme doktrimore, politike, ideologjike, a shkencore; përndryshe ai do t’a kishte të vështirë, në mos të pamundur, të botonte tekstet e tij ose të saj.

2. Falsitetet (gabimet logjike) mund të ndahen edhe në *falsitete gjuhsore* ose **formale** dhe *falsitete jogjuhsore* ose **materiale**.

Në të parin, përdoret një formë e gabuome argumentimi. Në të dytin, afirmohet diçka që nuk i përgjigjet botës reale.

Aristoteli përshekruan 13 falsitete, të cilat ai i ndan në dy klasat e treguome më nëlt. Termet latine për këto dy klasa janë *In Dictione* (falsitete gjuhsore ose formale) dhe *Extra Dictione* (falsitete jogjuhsore ose joformale).

Falsitetet *in dictione* (në gjuhë), përfshijnë: *ekuivokimin*, *amfibolinë*, *kompozimin*, *divizionin*, *aksentin*, dhe *trajtën e fjalës* (en, verbal form).

Falsitetet *extra dictione* (jasht gjuhës) përfshijnë: *aksidentin*, *ngatërrimin e deklaratës absolute* dhe *të kualifikuome*, *falsitetin e konsekuencës*, *argumentin përtej subjektit të diskutimit*, *falsitetin e shkakatit*, *falsitetin që (vetëm) shtron pyetjen* (en. *begging the question*), dhe *pyetjen komplekse*.

Sot njihen shumë falseti logjike. Deri tash, ndamja e tyre në kategori nuk ka gjetur pajtim në mes shkollarëve. Më poshtë do të jepet një ndamje që ka për qëllim të forcojë argumentin. Aty do të përfshihen problemet në gjuhë dhe arsytim, si edhe ndikimet e emocioneve.

### *Falsitetet Formale ose Gjuhsore*

Falsiteti formal shkelë parimet e formës së argumentit. Ai lidhet me paqartsinë e fjalëve ose strukturave gjuhsore. Tipikisht, prejse në argumentet e këtij tipi njëri prej termave përdoret me dy kuptime, atëherë këto falsitete i përkasin falsitetit të katër termave. Kjo ngecje logjike nuk mund të pasohet më tej, prandaj, ajo mund të emnohet edhe sipas termit latin *non sequitur* (nuk pason, nuk bartet).

### *Dykrutimsia- ekuivokimi*

lat. *aequivocus* ‘e paqartë’ < *aequus* ‘e njëjtitë + *vocō* ‘zë, thirrje, quajtje’. Ekuivokim quhet një fjalë që ka dy a më shumë kuptime, ose kur një term përdoret me dy a më shumë kuptime, p.sh.,

burrní – *burrat e një bashkësie (krabaso: graní)*

burrní – *sjellje tipike e një njeriu të civilizuar, ku mbí të gjitha vlersohet arsyeja, vetkontrolli, vullnetmirsia, etj.*

Në këtë tip falsiteti, një fjalë përdoret me dy a më shumë kuptime; secila në pjesë të ndryshme të argumentit.

p1. *Disa burra kanë burrni.*

p2. *S’ka grua që është burrë.*

pf. *Prandaj, s’ka grua që ka burrni.*

Ky falsitet logjik luan me kuptimin e fjalës burrni (koncept moral) dhe burrë (mashkull – njëna prej dy gjinive). Në traditën autentike shqiptare, termi ‘burrni’ është uniseks.

### *Amfibolia – paqartsia e lidhjes sintaksore*

Prej gre. *ἀμφιβολία* *amfibolía*, paqartsí, dyshim. Ky falsitet lidhet me çashtjet sintaksore, si rendi i fjalëve, referenca të paqarta, ose modifikues të keqrenditun. Në logjikë, ky falsitet lidhet me përdorimin e një fjalie të paqartë, të dyshimtë, ose që mund të ketë shumë kuptime.

Prejse gjuha shqipe është gjuhë e eptueshme, ajo i dallon trajtat gjuhsore me anë të mbaresave. Prandaj, falsitete të tilla mund të shmangen.

en. *The Duke yet lives that Henry shall despose* (Shakespeare Henry VI)

sq. *1. Duka që ende jeton, Henrin do ta hedhi përtej (vrasi).*

## 2. Dukën që ende jeton, Henri do të hedhi përtej (vrasi).

Në anglisht, emënat ‘dukë’ dhe ‘Henry’ nuk marrin mbaresa sipas ramjeve lakimore, prandaj nuk është e qartë se cili ka me vrá tjetrin. Në shqip, tipikisht, mbaresat lakimore do ta shmangnin një paqartsí të tillë.

### Falsiteti i kompozimit – predikimi i cilsisë së pjesës mbë tansinë

Ky falsitet ndodhë kur cilsitë e pjesëve i predikohen (atribohen, pohohen, presupozohen) tansisë në mënyrë jologjike; p.sh., kur folësi supozon që çka është e vërtetë për *pjesët* është e vërtetë edhe për *tansinë*.

A = hidrogjeni; B = uji; X = pezullimi

*Hidrogjeni është përbësë i ujit.* (A është pjesë e B)

*Hidrogjeni pezullohet në ajër.* (A ka cilsinë X)

*Prandaj, uji pezullohet në ajër.* (B ka cilsinë X)

Ndërsa pezullimi është i vërtetë për hidrogjenin (pjesën), ai nuk është i vërtetë për ujin (tansinë). Referenca këtu është e gabuome sepse ndërsa në *premisë* pezullimi merret si karakteristikë e hidrogjenit (pjesës), në përfudim, pezullimi merret si karakteristikë e ujit (tansisë).

### Divizioni – predikimi i cilsisë së tansisë mbë pjesën

Falsiteti i divizionit është e kundërta e falsitetit të kompozimit. Ai ndodhë kur një cilsí e tansisë u predikohet (supozohet) pjesëve.

A = hidrogjeni; B = uji; X = rrjedhja

*Hidrogjeni është përbësë i ujit.* (A është pjesë e B)

*Uji rrjedhë.* (B ka cilsinë X)

*Prandaj, hidrogjeni rrjedhë.* (A ka cilsinë X)

Ky është i gabuom sepse këtu, cilsia e rrjedhjes, e cila është vetí e ujit (tansisë), i predikohet hidrogjenit (pjesës).

### Aksenti ose theksimi

Ky falsitet mund të quhet edhe: *falsiteti i theksit, gabimi i theksit, gabimi i prozodisë*, etj. Ai ndodhë kur, nëpërmjet ndryshimit të vendit ku bjen theksi, kuptimi i kalohet një pjesë të një fjale, një fjale, ose një ideje që nuk përkon me gramatikën.

Në të folun, theksimi bëhet nëpërmjet ngritjes së lakores së zanit. Në të shkruom kjo arrihet duke e shkrua pjesën e theksuome me germa italike, të trasha (en. bold), të nënvi-  
zuome, ose me germa të mëdha.

Pa modifikime: *Xhonturqit ndaluan fjalët shqiptar dhe Shqipëri.*

*XHONTURQIT ndaluan fjalët shqiptar dhe Shqipëri.*

*Xhonturqit NDALUAN fjalët shqiptar dhe Shqipëri.*

*Xhonturqit ndaluan FJALËT shqiptar dhe Shqipëri.*

*Xhonturqit ndaluan fjalët SHQIPTAR dhe Shqipëri.*

*Xhonturqit ndaluan fjalët shqiptar DHE Shqipëri.*

*Xhonturqit ndaluan fjalët shqiptar dhe SHQIPËRI.*

Vene ré një shembull më të shkurtë,

*TI jé miku i saj.*

*Ti JÉ miku i saj.*

*Ti jé MIKU i saj.*

*Ti jé miku i SAJ.*

Kuptimi i të njëjëtës fjalë ndërron në varsi prej qëllimit të autorit. Prandaj, kuptimi autentik i frazës ndryshon. Në fakt, pá theksim, fraza mbetet thjeshtë informative.

#### Qitja jasht rrethanave kumtore (kontekstit)

Fjalët, frazat, e fjalitë e marrin kuptimin prej rrethanave kumtore. Prandaj, marrja e një segmenti prej një teksti dhe vendosja e tij në rrethana të tjera kumtore është jo vetëm falsitet logjik por edhe mashtrim.

Cakuom me përbaltë karakterin e Fishtës, stalinistët shqiptarë patën hjekun një segment prej një aserte të Fishtës ku ai, iritun sjedhjes jopatriotike, të pathukët, dhe egoiste të *agojve, bejve, pashave, e zogojve osmanlí, pati thanë, afërsisht: Ta marrë vesh tan bota mbarë që Gjergj Fishta nuk është më shqiptar.*

Në asertën e tij, Fishta donte të kumtonte që elitat shqiptare, në qoftë se ato mund të quheshin të tilla, mbryjtun metodash sundimi otoman, ishin çshqiptarizuum. Prandaj, në qoftë se nocioni ‘shqiptar’ përkufizohej ashtu siç dëshironte kjo oligarkí, nocioni i shqiptarit do të delte i bastarduom. Në këtë situatë, iritë mashtruesve, Fishta nuk dëshironte të njëhej më si “shqiptar” – sepse ky nocion, deformatiom burrniet, nuk përkonte më me nocionin e shqiptarit autentik.

#### Trajta e fjalës (en. verbal form)

Disa fjalë duken të përafërta në mes tyre, p.sh.,

demokrací, monarkí, anarkí, oligarkí.

Këto fjalë janë të ndryshëme prej njëna-tjetrës.

demo- <i>kraci</i>	populli		fuzizohet
olig- <i>arki</i>	një	grup	sundon
mon- <i>arki</i>	një	person	sundon
an- <i>arki</i>	nuk ka sundues		

Falsiteti kryesor në këto fjalë gjindet në termin ‘*demokraci*’, të cilën disa e interpretojnë si ‘populli sundon’. Sikur ‘populli’ të sundonte, nuk do të kishte qeveri. Fjala për këtë lloj shoqnie asht *anarki*. Kuptimi i drejtë i fjalës ‘demokraci’ është ‘fuqizim i popullit me u kërkua llogari sunduesve’. Kjo asertë mbështetet prej fakti që ‘kraci’ do të thotë fuqi, fuqizim; ndërsa ‘arki’ do të thotë sund; e drejtë me sundua.

### Falsitetet në arsyetim

Arsyetimi nënkupton lidhjen logjike në mes të evidencës dhe ideve. Këtu mund të sillet ndërmend edhe një herë thanja e Kantit se ‘Idetë pa evidencë janë të zbrazta dhe evidenca pa idé është e verbët.’

Përpjekja me lidhë evidencën me idetë mund të çojë në disa falsitete të veçanta. Por, le të sillet ndërmend se çka kuptohet me ‘evidencë’. Evidenca duhet të jetë:

- korrekte; pa gabime
- e mjaftueshme (këtu përfshihet edhe larmia)
- e lidhun me subjektin në diskutim ose idenë që evidenca mbështetë

Mã poshtë jepen disa falsitete që lidhen me evidencën, por të kihet parasysh që disa falsitete përfshijnë mã shum se një kategori.

1. *Korrektesa (en. accuracy)*. Argumentuesi mund të përdori evidencë që është qëllimisht ose joqëllimisht e pavërtetë. Këtu përfshihen falsitete si: *dordoleci, dilema fallso*, etj.

2. *Lidhja me idenë (en. relevance)*. Evidenca që nuk lidhet me subjektin në diskutim, përfshin falsitete si: *apeli ndaj motivit, analogjia e gabuome, harenga e kuqe, helmimi i pellgut, ndaj njeriut ose personit*, etj.

3. *Mjaftuesia*. Falsitete ku evidenca nuk mjafton përfshin: *arsyetimin qarkues, që (vetëm) shtron pyetjen (en. begging the question), përgjithsimin e përsheptuom*, etj.

### Falsiteti i shkakut (causal fallacy):

Jam i sigurtë që UFOtë e vranë fqinjim tim sepse në dhomën e tij u gjet libri, ‘Si t’u shpëtojme UFOve’. Ky falsitet mund të quhet edhe ‘arsyetim i përsheptuom’.

### Falsiteti shkak-pasojë (post-hoc, ergo propter hoc)

Falsiteti këtu lidhet me kronologjinë e ngjarjeve. Argumentuesi arsyeton, errtisht, që një ngjarje u shkaktua prej ngjarjes që ndodhi para saj. Shprehja latine është: *Pas kësaj, prandaj prej kësaj.*

*Menjëherë pasqë piva limonatë me erdhi gjumë; Limonata të ven në gjumë.*

### Nuk pason (lat. non-sequitur)

Shprehja popullore ‘po flet pa lidhje’ është e përafërt me falsitetin logjik ‘non-sequitor’ (nuk pason, nuk bartet, nuk shkon më tej). Ky falsitet ndodhë kur përfundimi nuk ka lidhje me premisat.

*Shtojza është analiste e mprehtë e retorikës sepse ajo lexon shum poezi.*

Në këtë asertë, autori nuk e mbështetë argumentin e tij se si leximi i poezive ndihmon analizën e retorikës. Vene ré falsitetin në formatin pasues.

p1. *Tan ata që lexojnë poezi janë ekspertë në analizën retorike.*

p2. *Shtojza lexon poezi.*

p.f. *Prandaj, Shtojza është eksperte në analizimin e retorikës.*

Në këtë argument mungon lidhja në mes të leximit të poezisë dhe analizës retorike. P1 do të punonte sikur ajo të ishte një aksiomë; një asertë që pranohet pa arsyetim, p.sh.,

p1. *Kushdo që qëndron në shí laget.*

p2. *Shtojza po qëndron në shí.*

p.f. *Prandaj, Shtojza është lagun.*

Këtu, p1 pranohet pa kundërargumentim.

### Falsiteti analogjik

Falsiteti analogjik ndodhë kur argumentuesi supozon që, prejse dý gjana janë të ngjashme në një cilsí, ato janë të ngjashme edhe në cilsí të tjera, p.sh.,

*Ai që sapo të ngrihet prej shtratit pin një birra*

është si

*ai që sapo të ngrihet prej shtratit lan dhambët.*

E para tregon adiktim, e dyta kujdes për shëndetin.

### 3. Apeli te autoriteti: (apeal to authority):

Me autoritet nuk nënkuptohet as kushdo që mund të postojë në internet as kushdo që është popullor. Prandaj, aserta si “Ky është libri më i mirë i vitit” sepse kështu shkruhet në sitin X, nuk ka mbështetjen e ekspertëve. Po ashtu, edhe argumenti: “Ky libër është i mirë sepse atë e lexoi një futbollist i njohun”.

### 4. Që kërkon/shtron pyetje (petitio principii)

Ky fallsitet ndodhë kur argumentuesi mbështetë një asertë në një premise që presupozon po këtë asertë, p.sh.,

*Frutat e papjekuna nuk duhen hangër sepse ato janë të papjekuna.*

Në këtë argument e vërteta përse frutat e papjekuna nuk duhen hangër nuk provohet as me evidencë as me arsye.

1) *Dihet se mollat janë të shëndetëshme.*

2) *Prandaj ha një mollë se të ban mirë.*

Në këtë argument, premisa 1) presupozon përfundimin 2).

### 14. Paradoksi i rrencit (Liar's paradox)

- *Mos u besoni kretasve sepse ata të gjithë rrëjnë.*

- *Më besoni mua sepse un vetë jam kretas.*

Asertat e folësit janë paradoksi sepse:

a) Sikur audienca t'i besonte atij, kretasit do të delnin të gjith rrenca.

b) Por, folësi vetë është kretas, prandaj sikur audienca t'i besonte atij, ajo do të besonte një rrenë.

#### **Argumenti**

p1. Të gjith kretasit rrëjnë!

p2. Un jam kretas!

pf. Un rrëj.

#### **Falsiteti**

p1. Të gjith kretasit rrëjnë!

p2. Un jam kretas!

pf. Un nuk rrëj.

### Përgjithësimi i nxituom (hasty generalization):

Marrja e një vendimi të nxituom lidhet me cungimin e njënjës prej tri parimeve kryesore të evidencës: *mjaftuesisë, lidhjes me subjektin, ose vërtetësisë*. Kështu, përgjithësimi i nxituom ndodhë kur vendimi (përfundimi) bazohet në evidencë të pamjaftueshme, kur evidenca nuk lidhet me subjektin në diskutim, ose kur evidenca është e pavërtetë.

Imagjino ju takoni një plak 110 vjeç duke pít wiski dhe duke tymosë një puro. Ju arsyetoni:

*Një kombinim i wiskit dhe purove të zgjatë jetën.*

Në punë, ju shikoni për telefonin tuaj por s'mund t'a gjeni. Ju arsyetoni;

*Njëni prej kolegëve ma vodhi telefonin.*

Këto janë përgjithësime, ose përfundime, të përsheptuome.

### Dordoleci (straw man)

Me cak të fitojë debatin, polemisti përpiqet t'a shtrajtojë dhe keqparaqesi argumentin e kundërshtarit të tij duke e zëvendësua kundërshtarin me një version ekstrem të tij (një dordolec), p., sh.,

a) *Duhet të investojmë më shumë në matematikë dhe në shkencat natyrore.*

b) *Është e qartë që ju urreni artet dhe muzikën.*

Këtu, personi b) i drejtohet jo folësit a), por një versioni të shtrajtuom të tij, një dordolec; ose një karikaturë të tij.

### Harenga e kuqe (red herring)

Kur polemisti nuk dëshiron, ose nuk ka mundsi, të mbrojë argumentin që është thalbsor në debat, ose kur dikush e pyetë atë direktisht rreth një subjekti që ai nuk dëshiron t'a trajtojë, atbotë ky polemist mund ta zhvendosi argumentin drejt një subjekti tjetër, p.sh.,

a) *Sikur ju të zgjidheshit, çfarë masash do të merrnit ju rreth papunsisë?*

b) *Çashtja që po rondon më shumë qytetin tonë është kriminaliteti. Le të flasim rreth metodave që do të përdorim për përmirsimin e cilësive të jetës së qytetarëve tanë.*

Emëni i kësaj praktike vjen prej përdorimit të një peshku, era a të cilit, përdoret me i humbë nuhatjen një qeni ndjekës.

### Falsiteti i shpenzimit (Sunk cost fallacy):

Kështu quhet gabimi logjik kur personi heziton me hjekë dorë prej një veprimi, sjellieje, a projekti sepse ai ka investuom shuma të mëdha ose ka shpenzuom kohë të gjatë në të, p.sh.,

*Ushqimet janë pothuaj të prishuna. Megjithatë, meqë shpenzuar të bodhat me i blé, dubet t'i hamë.*

*Humba shum të holla në short, prandaj dubet të vazhdoj me luajt deri sa t'i fitoj të gjitha.*

### Përgjithësimi i zgjanuom (broad generalization)

Në këto falsitete autori përdorë fjalë përgjithsuese si 'tan, të gjith, kurr, gjithmonë', me bā deklarata absolute a kategorike rreth diçkaje, p.sh,

*Nuk kam pá njeri që ban si ju; çdo ditë fleni deri në ora nantë.*

*Tan njerëzve u pëlqen fërliku; kush jeni ju të refuzoni mishin e pjekun.*

### Tejthjeshtimi (en. oversimplification)

Duke i thjeshtua çashtjet komplekse në zgjidhje të thjeshta, tejthjeshtimi shtrajton të vërtetën.

*Politikanët janë njerëz të korruptuom.*

*Prandaj, eliminimi i tyne do të krijonte një bashkësi të përsosun.*

### Dilema e rreme (false dilemma)

Ky falsitet ndodhë kur argumentuesi deklaron që problemi ka vetëm dy zgjidhje, tipikisht të dyja ekstreme. Argumenti prezantohet në formën: ose kjo... ose ajo..., kështu... ose ashtu..., ose... ose...

*Ose e doni ose e urreni atdheun; s'ka rrugë tjetër.*

*Ose me né ose kundra nesh; s'ka rrugë të tretë.*

Ky falsitet mund të prezantohet edhe si premisë kushtore, p.sh.,

*Në qoftë se nuk votoni për mua, vendi do të shkatërrohet.*

### Mungesa e alternativave

Ky gabim logjik ndodhë kur autori ngulmon që një problem i dhanun ka vetëm një zgjidhje, p.sh.,

*Ju nuk keni shteg tjetër përveçse të merrni një hua me 50% interes.*

### Falsitetet emocionale

Veçsisht në retorikë, detyra e retorit është që të bindi audiencën me ndjekë drejtimin që ai ofron. Shpesh, qëllimi i autorit arrihet nëpërmjet nxitjes së emocioneve të audiencës. Këto falsitete mund të ndahen në dy kategori: 1) emocione pozitive dhe 2) emocione negative. Në mënyrë të thjeshtuome ato mund te shihen edhe si: *uzdajë* ose *drojë*.

### Emocionet Pozitive

Kur retorikë cakton të nxisi emocione pozitive në një audience, ai ofron uzdajë, jetë më të mirë, pasuní, lumní, si edhe ndjenja pozitive ndaj atyne që vuajn, janë të pafat, ose të skajtuom prej bashksisë.

#### Apel te keqardhja (appeal to pity)

Në këto rrethana, retorikë përpiket me fitua mbështetjen e audiencës duke eksitua në këtë audiencë emocionin e keqardhjes për dikë ose për diçka, p.sh.,

*A nuk ju vejn keq për emigrantët, njerëz të skamun e të vuajtu. Po sikur ju të gjindeshit në atë situatë? Le t'ua hapim derën të gjithëve, le t'a hapim kufinin. Në fakt, le të mos kemi kufi fare.*

#### Apeli te zulma

Sipas Niçes, popullariteti është një argument kundër vlerës autentike, p.sh., me marë këshilla moratorie prej një elektricisti profesionist, ose letërsie prej një futbollisti, p.sh.,

*Futbollisti më e famëshëm i X rekomandon dhjet librat më të mirë.*

Kjo deklaratë është falsitet sepse futbollisti në fjalë nuk njihet për ekspert letërsie. Në fakt, ka mundsi që ai s'din as me lexua.

#### Apeli te tradita

Sipas Niçes, fakti që kemi mija vjet që bajmë diçka gabim nuk na jep të drejtë t'a vazhdojmë këtë gabim, p.sh.,

- Instrumentet muzikore orientale si *çiftelia, shargia, veglat e abengut, dhe ato të tallavasë*, janë bamë traditë.
- Shqipja zyrtare nuk ka paskajore tash 70 vjet; kjo është traditë.

#### Përgjithsimet vezulluese (en. glittering generalities)

Kjo është një strategji që përdoret prej fanatikëve dhe manipuluesve të çdo lloji. Në asertat e tyne gjinden fjalë si: *'patriotizmi, atdheu i bashkuom, gjuha nanë, atdheu, atdhe-dashnia, mëmëdheu, virtyti, vesi, zoti, parajsa, ferri, anmik, mike, përçasë, etj.'*

Folës të tillë nuk argumentojnë. Ata akuzojnë, shajnë, ose lëvdojnë. Shrpehjet e tyne, tipikisht të parafabrikuome, janë kaq të ngarkuome me emocione të lidhuna me vlerat e bashksisë saqë ato janë 'verbuese'.

### Emocionet Negative

Ndërsa emocionet pozitive mund të lidhen me moralin e naltë, patriotizmin, e të tjera, emocionet negative lidhen me mposhtjen e kundërshtarit nëpërmjet shpifjeve ose shoqnimeve të kundërshtarit me bama a vese të pamoralëshme.

Ndaj (kundër) personit (Ad hominem)

### 1. *Abuzimi i kundërshtarit*

Falsiteti 'ndaj njeriut' ndodhë kur argumentuesi përpiqet të zhvlersojë pozicionin e kundërshtarit duke i sulmua atij karakterin ose duke sjellë në fokus fakte a ngjarje jo të favorëshme që lidhen me kundërshtarin. Qëllimi këtu është që, nëpërmjet diskreditimit të personit, të diskreditohet argumenti i këtij personi, p.sh.,

*Ai vetë ka një sëmundje kronike, prandaj ai nuk mund të jetë doktor i mirë.*

Një shembull tjetër i parashtruom në formën e silogjizmit:

*p1. Atyne që thejnë ligjin nuk u lejohet të bahen zyrtarë.*

*p2. Para 30 vjetësh, X u arrestua sepse ai po voziste makinën me shpejsí.*

*pf. Prandaj, bëmja e tij kryeministër do të ishte bëmja e kriminelit udhëheqës i vendit.*

### 2. *Origjina ose falsiteti gjenetik*

Këtu argumentohet që bindja e kundërshtarit mbështetet në baza personale, jo logjike, p.sh.,

*Ju jeni i paguom që të kundërshtoni planin tonë.*

*Ju parashtroni plane të tilla sepse ju jeni sherbëtor i X.*

Këtu, nuk arsyetohet rreth asaj që thotë kundërshtari.

Argumenti prej injorancës (to ignorance):

Ky argument lidhet më shumë me arsyetimin, por ai është shpesh i ngarkuom edhe me emocione. Prandaj, këtu ai përfshihet me falsitetet e motivuome prej emocionesh.

Ky falsitet ndodhë kur argumentuesi beson që 'x' është e vërtetë sepse nuk ka prova kundër 'x', ose që 'x' është e pavërtetë sepse nuk ka prova pro 'x', p.sh.,

*- Ka Shtojzovalle sepse deri sot nuk ka prova që ato nuk egzistojë.*

ose

*- Nuk ka Shtojzovalle sepse deri sot nuk ka prova që ato egzistojnë.*

Çashtja me këto dy aserta është se mungesa e evidencës nuk është evidencë as pro as kundër diçkaje.

Apeli te frika

Ky falsitet ndodhë kur dikush përdorë frikën ose kërcënimin me nxitë audiencën që të pranojë një argument, p.sh.,

*Un nuk do t'i afrohesha murit të vjetër sepse aty ka gjarpëna helmues.*

Nuk do të thotë që rreziku nuk është i vërtetë, por që egzistenca e rrezikut nuk argumentohet me evidencë dhe arsye të shëndoshë; dëgjuesi nuk e din nëse folësi po rrenë apo po thotë të vërtetën.

Shembull tjetër:

*Në qoftë se nuk do të votoni për partinë tonë, vendi do të kthehet në tirani.*

Pjerrsia e rrëshqitshme (slippery slope)

Pa u mbështetë në arsye a evidencë, argumentuesi thotë që po pranove një ngjarje të caktuome, një seri ngjarjesh të tjera shumë më të randa do të pasojnë, p. sh.

*Marijuana nuk duhet të ligjsobet, përndryshe përdoruesit e saj do të mësoheshin me substancë dhe kështu të gjithë do të përfundonin në adiktim; rrugët do të ishin plot me njerëz të adiktuom në substanca të ndryshëme—marijuana është kapërcelli i adiktimit.*

Falsiteti 'edhe ti' (appeal to hypocrisy; lat. tu quoque 'edhe ti')

Këtu argumentuesi përpiqet të kundërshtojë pozicionin e kundërshtarit nëpërmjet akuzave për sjellje negative. Shih përgjigjen 'B' më poshtë.

a) Ajo që ti thé, ishte rrenë.

b) Edhe ti rrenë mjaft shpesh.

Fakti që a) rrenë shpesh nuk ka lidhje me asertën e tij rreth asertës së b). Këtu personit 'b)' i kërkohet me mbrojtë të vërtetën e asertës së tij.

## Glosari

### FJALA -- PËRSHKRIMI

apodeixis -- provë; demonstrim

eikos -- ka gjasë (en. is probable)

endoxa -- opinione të pranuome / besime popullore

enthymēma -- enthemimë; argument i cinguom

epagôgē -- induksion; arsyetim induktiv

ēthos -- karakter

gnômē (γνώμη) -- fjalë e urtë, aforizëm, maxim

krisis -- gjykim

lexis -- stil

logos -- argument, etj.

paradeigma -- shembull, gjedhe, egzemplar

pathē -- emocione

phronēsis -- dije praktike (en. practical intelligence)

pistis -- mënyra bindieje (prova, argumente, arsyetime, besime, bindje, detyrime, etj)

protasis -- premisë

sēmeion -- shenjë

sullogismos -- deduksion; arsyetim deduktiv

technē -- art

topos – vend

Prej enciklopedisë së filozofisë së Universitetit të Stanfordit.